



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 117 prot.

Kamëz, më 22.08.2023

V E N D I M

Nr. 83, datë 22.08.2023

P Ë R

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE SHITESË QË PËRFITOJNË BONUS QIRAJE, BANESAT E TË CILËVE PREKEN NGA REHABILITIMI DIGËS SË LIQENIT TË PASKUQANIT DHE NDËRTIMI I PEDONALES DHE ZONAVE REKREATIVE TË LIQENIT PASKUQANIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.08.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.54 Datë 16.08.2023 Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore; Ligjit nr. 22/2018 Për Strehimin Social; Ligjit nr. 45/2019 Për Mbrojtjen Civile; VKM nr.409 date 15.06.2022 “Për përjashtimin nga procesi legalizimit për poseduesit pa leje që nuk legalizohen”; VKB- në nr.145 datë 25.11.2022 “Për miratimin e vlerës subvencionimi të qirasë për familjet që preken nga projekti “Rehabilitimi digës së liqenit të paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të Liqenit Paskuqanit”; VKB-së nr.146 datë 25.11.2022 “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë bonus qiraje banesa e të cilëve preket nga projekti “Rehabilitimi digës së liqenit të paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të Liqenit Paskuqanit”; Urdhër nr. 945 datë 6.11.2022 “Ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe trajtimin e poseduesve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit të Liqenit të Paskuqanit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Listën e familjeve shtesë që do të trajtohen me bonus qiraje, për shkak se banesat e tyre preken nga projekti “*Ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit*” dhe “*Rehabilitimi digës së Liqenit të Paskuqanit*”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

2. Lista e familjeve përfituese është pjesë e aneksit nr.1 të këtij vendimi.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 e këtij vendimi do të përballohen në raportet financiare sipas pikës 2 Kreu II të VKM nr. 409 date 15.06.2022 “Për përjashtimin nga procesi legalizimit për poseduesit pa leje që nuk legalizohen”.
4. Të ngarkojë grupin e punës për ndjekjen dhe trajtimin e poseduesve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit të Liqenit të Paskuqanit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Perfekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

